



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 17, datë 20.01.2021

MBI

PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË FILLUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE NR. 230, DATË 15.12.2020 “MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 415, SERIA P18K, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË “BLAC ENERGY” SH.P.K., ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 157, DATË 09.07.2018.

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 95, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 8 dhe 9 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 58, datë 18.04.2017; si dhe nenit 16 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.1.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr9/10 prot, datë 16.01.2021, të përgatitur nga Grupi i punës, “Mbi përfundimin e procedurës administrative të filluar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 230, datë 15.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “BLAC ENERGY” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 157, datë 09.07.2018”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin Nr. 230, datë 15.12.2020, vendosi për fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “BLAC ENERGY” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 157, datë 09.07.2018.
- Vendimi i Bordit të ERE Nr. 230, datë 15.12.2020, i është dërguar për dijeni shoqërisë “BLAC ENERGY” sh.p.k., nëpërmjet shkresës së ERE nr. 1172/9-1 Prot, datë 23/12/2020.
- Në vijim të këtij njoftimi, në datë 13.01.2021, nga verifikimet e Drejtorisë së Financës në ERE rezultoi dhe u bë me dije se, janë shlyer detyrimet për pagesat e rregullimit për të cilat rezulton debitore shoqëria.

- Referuar afateve të përcaktuara nga ERE në njoftimin e dërguar për dijëni të subjektit, rezulton se subjekti ka shlyer detyrimet e prapambetura brenda afatit të përcaktuar në këtë njoftim e të sanksionuar në vendimin e Bordit të ERE Nr. 230/2020.
- Për sa më sipër, rezulton se shoqëria “BLAC ENERGY” sh.p.k. nuk është debitore ndaj ERE për pagesat e prapambetura të Rregullimit.
- Në nenin 8 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 58, datë 18.04.2017, parashikohet se: Pas marrjes së përgjigjes më shkrim nga i licencuari sipas parashikimeve, personat e ngarkuar që ndjekin këtë procedure, do të shqyrtojnë këtë përgjigje brenda 30 ditëve dhe do të përgatisin një relacion për Bordin mbi argumentet e paraqitur dhe veprimet e ndërmarra nga i licencuari dhe do t’i propozojnë Bordit. a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës në rast se i licencuari dëshmon mungesën e kushteve të përcaktuara në pikat "a", "b", "c", "ç" dhe/ose "d" të nenit 5 të kësaj rregulloreje.
- Në nenin 95 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, **kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.**
- Dispozitat e nenit 95 zbatohen për çdo procedurë administrative pavarësisht nëse është filluar kryesisht nga organi publik ose me kërkesë të palës. Në këtë rast "qëllimi" i procedurës, lidhet ngushtësisht me marrjen e masave ligjore kryesisht nga organi që ka kompetencën, me qëllim shmangien e faktorit që ka nxitur vendimmarrjen.
- Vërtetimi i shlyerjes së pagesave të prapambetura, faktori ndryshim i statusit të subjektit të cilit i kundrejtohet masa administrative duke rezultuar në rënien e shkakut që imponoi marrjen e masës ligjore.
- Në nenin 9, germa “a” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 58, datë 18.04.2017, parashikohet se me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë: a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Përfundimin e procedurës administrative të filluar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 230, datë 15.12.2020 “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “BLAC ENERGY” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 157, datë 09.07.2018.
2. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s Nr. 230, datë 15.12.2020 “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë

elektrike, dhënë shoqërisë “BLAC ENERGY” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 157, datë 09.07.2013.

3. Grupi i Punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.